

**LIGJI NR. 04/L-154
PËR PUNIMET NGA METALET E ÇMUARA**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR PUNIMET NGA METALET E ÇMUARA

**Neni 1
Qëllimi**

1. Me këtë ligj përcaktohen kushtet, mënyra dhe veprimi i kontrollit të punimeve të punuara nga metalet e çmuara si dhe, tregtimi i tyre.
2. Përcaktohen kërkesat teknike me të cilat definohet shkalla e pastërtisë, përbërjes dhe përmbajtjes së metaleve tjera, pjesë prej metaleve jo të çmuara dhe jo metaleve.
3. Rregullon kushtet dhe mënyrën e shënimit në harmonizim me shenjat ndërkombëtarisht të pranuar, si dhe detyrimet mbi shpenzimet për ekzaminimet dhe shënimin, rregullon realizimin e inspektimit dhe mbikëqyrjes metrologjike.
4. Siguron që punimet nga metalet e çmuara tregtohen në përputhje me standardet e mbrojtjes së konsumatorëve.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për punimet të papërpunuara siç janë: granula, shufra, pllaka, fleta, tela, foli ari dhe të ngjashme, në rast se janë të destinuara për shitje.

**Neni 3
Përjashtimi**

1. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për:

- 1.1. punime të cilat janë të importuara përkohësisht si një mostër e punimit, punimet për qëllim të promovimit të tregtisë, mostrat për ndërkrahime laboratorike;
- 1.2. punime e veshura plotësisht me smalt, gurë të çmuara, perla apo veshje jo metalike;
- 1.3. punime që metali bazë nuk është metal i çmuar, por janë të veshura plotësisht me metale të çmuara;
- 1.4. punimet e destinuara për eksport, mund të kenë përbërje dhe përmbajtje tjetër nga ajo që është e paraparë me këtë ligj;
- 1.5. punime me gurë të çmuar, perla apo punime të tjera të cilave pesha dhe vlera e metalit të çmuar është nën një (1) gram;
- 1.6. instrumente muzikore, pjesët e instrumenteve muzikore të punuara nga metalet e çmuara;
- 1.7. pajisjet që janë krijuar për qëllime mjekësore, dentare, veterinarë shkencore dhe teknike;

1.8. shufra dhe granula të metaleve të çmuara të përdorura në shërbimin bankar, duke përfshirë pllaka të aksioneve;

1.9. monedha antike, medalje që janë punuara nga metalet e çmuara.

1.10. punim i thyer, metali e thyer të destinuar për përpunim të mëtutjeshëm për rafinim.

Neni 4 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Ministria** - Ministria përkatëse e Tregtisë dhe Industrisë;

1.2. **Ministër** - Ministri përkatës i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë;

1.3. **Metal i çmuar** - platin, ari, paladium dhe argjend;

1.4. **Aliazh i metaleve të çmuara** - përzierjen homogjene të një metali të çmuar me një ose më shumë metale tjera;

1.5. **Punim** - çdo artikull i punuar tërësisht apo pjesërisht nga metalet e çmuara dhe aliazhet e tyre;

1.6. **Pastërtia** - përmbajtja e caktuar e metalit të çmuar në masën e përgjithshme të aliazhit, e shprehur në njëmijë (1000g) gram;

1.7. **Shkallë e pastërtisë** - përmbajtje më e lartë e metaleve të çmuara në masën e përgjithshme të aliazhit, e shprehur në njëmijë (1000g) gram;

1.8. **Shenja e harmonizimit** - konformiteti i punimit me kërkesat e përshkruara si dhe përputhshmërinë me pastërtinë e deklaruar;

1.9. **Veshje me metale të çmuara** - një shtresë të metalit të çmuar, e cila e mbulon të gjithë pjesën e punimit;

1.10. **Lidhëse** - një lidhje nga metalet e çmuara, të cilat mund të përdoren vetëm si lidhje.

1.11. **Punim i papastër** - metal i thyer i destinuar për përpunim të mëtutjeshëm për rafinim;

1.12. **Gjysmë punim** - punim i papërpunuara me qëllim të përpunimit drejt punimit final;

1.13. **Shufra dhe granula të metaleve të çmuara** - pjesë të metaleve të papërpunuara - thyera;

1.14. **Inspektimi metrologjike** - mbikëqyrje metrologjike e një punimi, shërbimi, procesi ose të një sistemi matës, sipas kërkesave të caktuara .

1.15. **Metoda statistikore** - analiza kimike-kuantitative të më shumë se dhjetë (10) copë të punimeve të metaleve të çmuara.

1.16. **Laboratori i metaleve të çmuara** – laboratorit për kontrollimin e cilësisë së punimeve nga metalet e çmuara.

Neni 5 Detyrat dhe Përgjegjësit e laboratorit për fushën e punimeve nga metalet e çmuara

1. Në kuadër të Drejtoratit të Metrologjisë së Kosovës në pajtim me Rregulloren përkatëse për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë Tregtisë dhe Industrisë,

funksionon laboratori i metaleve të çmuara i cili kryen punë profesionale në fushën e kontrollit të cilësisë së punimeve nga metalet e çmuara.

2. Në kryerjen e punëve nga paragrafi 1. i këtij neni, Laboratori i metaleve të çmuara kryen këto detyra:

- 2.1. përcakton shenjën e prodhuesit;
- 2.2. mban evidencën e shenjave të prodhuesit;
- 2.3. kryen ekzaminim dhe shënjimin e punimeve;
- 2.4. kryen ekzaminim cilësisë së metaleve të çmuara dhe legurave të tyre;
- 2.5. bashkëpunon me organet inspektuese, organet tjera përgjegjëse dhe ofron ndihmë profesionale në fushën e kontrollit të cilësisë së punimeve.

3. Në rast kontesti të laboratorit me organet tjera përgjegjëse, Drejtorati i Metrologjisë së Kosovës, është organi i fundit në marrjen e vendimit në fushën e kontrollit të cilësisë së punimeve.

Neni 6

Kërkesat teknike për punime

1. Punimet duhet të kenë një nga shkallët të pastërtisë të përcaktuara me standardin ISO 9202:1991 si në vijim:

1.1. punimet e punuara nga Platini:

- 1.1.1. 950/1000 nëntëqind e pesëdhjetë pjesë në njëmijë gram;
- 1.1.2. 900/1000 nëntëqind pjesë në njëmijë gram;
- 1.1.3. 850/1000 tetëqind pesëdhjetë pjesë në njëmijë gram;

1.2. punimet e punuara nga Ari:

- 1.2.1. 916/1000 nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë pjesë në njëmijë gram;
- 1.2.2. 750/1000 shtatëqind e pesëdhjetë pjesë në njëmijë gram;
- 1.2.3. 585/1000 pesëqind e tetëdhjetë e pesë pjesë në njëmijë gram;
- 1.2.4. 375/1000 treqind e shtatëdhjetë e pesë pjesë në njëmijë gram;

1.3. punimet e punuara nga paladiumi;

- 1.3.1. 950/1000 nëntëqind e pesëdhjetë pjesë në njëmijë gram;
- 1.3.2. 500/1000 pesëqind pjesë në njëmijë gram;

1.4. punimet e punuara nga argjendi;

- 1.4.1. 925/1000 nëntëqind e njëzete e pesë pjesë në njëmijë gram;
- 1.4.2. 835/1000 tetëqind e tridhjetë e pesë pjesë në njëmijë gram;
- 1.4.3. 800/1000 tetëqind pjesë në njëmijë gram;

2. Punimet e punuara me farkëtim si: monedha ari, monedha argjendi, pllaka përkujtimore e të ngjashme, duhet të kenë këto shkallë të pastërtisë:

2.1. punimet e punuara nga Platini:

2.1.1. 999/1000 nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë pjesë në njëmijë gram;

2.1.2. 950/1000 nëntëqind e pesëdhjetë pjesë në njëmijë gram;

2.1.3. 900/1000 nëntëqind pjesë në njëmijë gram;

2.1.4. 850/1000 tetëqind e pesëdhjetë në njëmijë gram;

2.2 punimet e punuara nga Ari;

2.2.1. 999/1000 nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë pjesë në njëmijë gram;

2.2.2. 995/1000 nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë pjesë në njëmijë gram;

2.2.3. 990/1000 nëntëqind e nëntëdhjetë pjesë në njëmijë gram;

2.2.4. 986/1000 nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë pjesë në njëmijë gram;

2.2.5. 916/1000 nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë pjesë në njëmijë gram;

2.2.6. 900/1000 nëntëqind pjesë në njëmijë gram;

2.2.7. 875/1000 tetëqind e shtatëdhjetë e pesë pjesë në njëmijë gram;

2.3. punimet e punuara nga paladiumi;

2.3.1. 999/1000 nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë pjesë në njëmijë gram;

2.3.2. 950/1000 nëntëqind e pesëdhjetë pjesë në njëmijë gram;

2.3.3. 500/1000 pesëqind pjesë në njëmijë gram;

2.4. punimet e punuara nga argjendi;

2.4.1. 999/1000 nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë pjesë në njëmijë gram;

2.4.2. 925/1000 nëntëqind e njëzetë e pesë pjesë në njëmijë gram

2.4.3. 900/1000 nëntëqind pjesë në njëmijë gram

2.4.4. 835/1000 tetëqind e tridhjetë e pesë në njëmijë gram

2.4.5. 800/1000 tetëqind pjesë në njëmijë gram

Neni 7

Vlerësimi i Shkalles se Pastërtisë

Pastërtia e një punimi i cili është ndërmjet dy shkallëve të pastërtisë të përcaktuara sipas nenit 6 të këtij ligji do të konsiderohet si punim i shkallës me të ulët të pastërtisë ndërmjet atyre dy shkallëve.

Neni 8

Shënjimi i punimeve me shenjë

1. Prodhuesit janë të detyruar që punimet të cilat i prodhojnë ti shënjon me shenjen e prodhuesit dhe shenjen e pastërtisë.

2. Shenja e pastërtisë sipas paragrafit 1. këtij neni duhet ti përgjigjet njëzë nga shkallët e pastërtisë sipas nenit 6 të këtij ligji.
3. Punimet e importuara duhet të kenë së paku shenjën e pastërtisë.
4. Punimet nga metalet e çmuara të cilat prodhohen, para vendosjes në qarkullim në treg duhet të kontrollohen dhe të shënjoen me shenjën e harmonizimit.
5. Punimet nga metalet e çmuara të cilat importohen, para vendosjes në qarkullim në treg duhet të kontrollohen dhe të shënjoen me shenjën e harmonizimit.
6. Shenjen e harmonizimit e vendos vetëm Laboratori i metaleve të çmuara në kuadër të Drejtoratit të Metrologjisë.
7. Me akt nënligjor përcaktohet shenja e pastërtisë, prodhuesit, dhe shenja e harmonizimit.

Neni 9 Punimet të cilat përmbajnë lidhëse

Punimet të cilat përmbajnë lidhëse, shkalla e pastërtisë së lidhëses duhet të jetë e njëjtë me shkallën e pastërtisë të punimit bazë, sipas nenit 6 të këtij ligji.

Neni 10 Përmbajtja e punimeve të metaleve të çmuara

1. Punimet mund të përmbajë pjesë të metaleve jo të çmuara dhe pjesë të metaleve të çmuara, me kusht që ato lehtë të ndahen fizikisht nga tërësia e punimit.
2. Pjesët e metaleve jo të çmuara nuk duhet të jenë të veshura më një shtresë prej metali të çmuar e cila do t'u japë atyre pamjen e metaleve të çmuara.
3. Veshja prej metali të çmuar nuk duhet të ketë pastërti më të ulët se punimi që e ka mbuluar.

Neni 11 Vlerësimi i Pastërtisë

1. Para vendosjes në treg, prodhuesi është i obliguar që punimin ta ofroj për ekzaminim dhe shenjim, me qëllim të vërtetimit të përputhshmërisë së tyre me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.
2. Laboratori i metaleve të çmuara pas ekzaminimit të punimeve nga paragrafi 1. i këtij neni, lëshon raport me shkrim me të cilin ceket sasia dhe cilësia e punimeve të ekzaminuara.
3. Një kopje e raportit me shkrim i dorëzohet palës.

Neni 12 Shënjimi me shenjën shtetërore

Punimi i importuar dhe i punuar nga platina, ari dhe paladiumi në masë më pakë se një (1g), gram dhe punimet nga argjendi i cili është në masë më pakë se tre (3g) gram nuk shënjoen me shenjën e prodhuesit as me shenjën e pastërtisë, por pas ekzaminimit dhe plotësimit të kushteve të përcaktuar me këtë ligj shënjoen me shenjën shtetërore.

Neni 13 Kufiri i pastërtisë

1. Punimet e përbëra nga pjesë të ndryshme, me shkallë të ndryshme të pastërtisë së metalit të njëjtë të çmuar, në mes të të cilëve nuk ka kufi të dallueshëm të pastërtisë, duhet të mbajnë shenjën e pastërtisë së aliazhit me cilësi më të vogël.

2. Punimet e përbëra nga pjesë të ndryshme të metaleve të ndryshme të çmuara, i cili nuk ka kufij të pastërtisë qartësisht të dallueshëm, duhet të shënjohe me shenjën e pastërtisë me të ulët të metalit të çmuar.

3. Punimet tek i cili kufiri i pastërtisë është qartësisht i dallueshëm, secila pjesë duhet të shënjohe me shenjën përkatëse të pastërtisë.

4. Punimet që në përbërje ka pjesë nga metalet e çmuara dhe pjesë të gurëve të çmuar, duhet të shënjohe me pastërtinë e metalit të çmuar.

5. Kur veshja e punimit ka pastërti me të madhe se punimi bazë, duhet të shënjohe me pastërtinë e punimit bazë.

Neni 14 Ekzaminimi

1. Punimet në pronësi personale nuk i nënshtrohet ekzaminimit dhe shënjitimit të detyrueshëm.

2. Punimet në pronësi personale i nënshtrohet ekzaminimit dhe shënjitimit të detyrueshëm nëse poseduesi i tyre i vendosë ato në shitje.

3. Me kërkesën e poseduesit, laboratorit i metaleve të çmuara kryen ekzaminimin dhe shënjitimin e punimit edhe nëse poseduesi nuk i vendosë ato në shitje.

4. Nëse me rastin e ekzaminimit të punimeve nga metalet e çmuara në pronësi personale, vërtetohet se ato në pikëpamje të pastërtisë nuk kanë as shkallën më të ultë të pastërtisë të përcaktuar me këtë ligj, punimet e tilla nuk shënjohe dhe i kthehen poseduesit.

Neni 15 Riekzaminimi

Nëse punimet pas shënimit nga ana e laboratorit të metaleve të çmuara, ripërpunohen ose bëhet ndonjë ndryshim në to, atëherë punimet duhet ti nënshtrohen ekzaminimit përsëri.

Neni 16 Plotësimi i formularit

1. Prodhuesi, përkatësisht përfaqësuesi i autorizuar, me rastin e dorëzimit të punimeve në laboratorin e metaleve të çmuara, për ekzaminim dhe shënjim ka për detyrë të plotësoj formularin me të dhënat mbi llojin e punimit, numrin e tyre, masën, përbërjen dhe përmbajtjen e legurës.

2. Importuesi, përkatësisht përfaqësuesi i autorizuar, me rastin e dorëzimit të punimeve në laboratorin e metaleve të çmuara, për ekzaminim dhe shënjim ka për detyrë të plotësoj formularin me të dhënat mbi llojin e punimit, numrin e tyre, masën, shkallën e pastërtisë dhe Dokumentin Unik Doganor.

Neni 17 Bartja e pjesës së vulosur

Ndalohet bartja e pjesës së vulosur nga një punim në punimin tjetër.

Neni 18 Shpenzimet e ekzaminimit

1. Shpenzimet e ekzaminimit dhe shënjitimit të punimeve i bartë parashtruesi i kërkesës.

2. Me akt nënligjor përcaktohen tarifa me rastin e kryerjes së këtyre shërbimeve.

3. Të ardhurat nga ekzaminimi dhe shënjitimit të punimeve derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

4. Nëse gjatë shënjimit, punimet nga metalet e çmuara dëmtohen, zhdëmtimin e punimeve e bart Drejtorati i Metrologjisë në përputhje me Ligjin përkatës për Detyrime.

Neni 19

Vendosja në treg e punimeve nga metalet e Çmuara

Punime nga metalet e çmuara vihen në qarkullim vetëm nëse ato i përmbushin kërkesat teknike dhe të jenë të shënuara sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 20

Ndarja e punimeve nga metalet e çmuara

Punimet nga metalet e çmuara që janë të ekspozuara për shitje duhet të jenë të ndara prej punimeve që nuk janë punime nga metalet e çmuara-bizhuteri.

Neni 21

Vendosja e vendimit në vend të dukshëm

1. Shitësi i punimeve nga metalet e çmuara duhet të ketë foton e vulave shtetërore në vend të dukshëm, thjerrëzën zmadhuese me të cilën mund të dallohen shenjat e punimeve, tabelat me shkallë të pastërtisë të lejuar sipas dispozitave të këtij ligji si dhe peshoren të klasës së saktësisë II të verifikuara nga laboratorit i masës në Agjencionin e Metrologjisë së Kosovës

2. Prodhuesi, importuesi përkatësisht përfaqësuesi i autorizuar është i obliguar që në hapësirën e vetë shitëse në vend të dukshëm të mbajë vendimin mbi shenjën e tij.

Neni 22

Mbikëqyrja Metrologjike

Mbikëqyrjen metrologjike dhe zbatimin e këtij ligji dhe të akteve tjera nënligjore në fushën e punimeve nga metalet e çmuara e kryen Inspektorati i Metrologjisë dhe Inspektorati i Tregut.

Neni 23

Përgjegjësitë e Inspektoratit të Metrologjisë

1. Inspektorati i Metrologjisë kryen mbikëqyrjen metrologjike mbi:

1.1. Punimet të cilat vendosen në treg në kuptimin e përmbushjes së kërkesave teknike të këtij ligji;

1.2. Subjektet që merren me grumbullimin e punimeve nga metalet e çmuara për përpunimet të mëtutjeshëm;

1.3. Subjektet që merren me punimin e metaleve të çmuara.

Neni 24

Mbikëqyrja dhe Masat Administrative

1. Mbikëqyrjen e punimeve nga metalet e çmuara në qarkullim e bënë Inspektorati i tregut që ka të drejtë të ndalojë për kohësisht nga shitja punimin i cili nuk është i shënuar sipas dispozitave të këtij ligji dhe i detyron të dërgoj për kontrollim të cilësisë në laboratorin e metaleve të çmuara.

2. Punimet të cilave iu ndalohet shitja duhet të tërhiqen nga qarkullimi, paketohen, blombohen nga inspektorati i tregut.

3. Prodhuesi, importuesi i punimeve është i obliguar që punimet e blombuara nga organi inspektues brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve së bashku me procesverbalin e inspektorit të lëshuar nga inspektorit ti sjell për kontroll të cilësisë dhe shënjim në laboratorin e metaleve të çmuara.

4. Për punimet të cilat pas analizës laboratorike konstatohet se shkalla e pastërtisë nuk është në pajtim me paragrafin 1. i nenit 6 të këtij ligji, Drejtorati i Metrologjisë Ligjore merr vendim për prishjen e punimeve që nuk janë konform kërkesave teknike të këtij ligji.

5. Pala e pakënaqur me vendimin e Drejtoratit të Metrologjisë Ligjore mund të parashtroj ankesë në komisionin profesional për ankesa i cili formohet me vendim të Ministrit të Ministrisë përkatëse të Tregtisë dhe Industrisë.

6. Komisioni profesional për ankesa përbëhet prej tre (3) anëtarëve, dy (2) anëtarë të përhershëm dhe një (1) anëtarë caktohet nga rasti në rast.

7. Mandati i anëtarëve të komisionit profesional për ankesa është tre (3) vjeçar.

8. Ankesa i parashtrohet komisionit në afat prej pesë (5) ditëve nga marrja e vendimit.

9. Ankesa e parashtruar e ndalon ekzekutimin e Vendimit

10. Pala e pakënaqur më Vendimin e Komisionit profesional, i drejtohet gjykatës kompetente sipas legjislacionit në fuqi

Neni 25 Komisioni për ankesa

1. Komisioni shqyrtimin e ankesës duhet ta shqyrtoj në afat prej pesë (5) ditësh nga marrja e ankesës.

2. Komisioni mund të merr vendim që të bëhet riekzaminimi i punimeve nga metalet e çmuara për ankesë e bërë nga pala.

3. Nëse vendimi i drejtoratit përputhet me raportin e analizës të lëshuar nga riekzaminimi, të gjitha shpenzimet i bart pala dhe ekzekutohet vendimi i drejtoratit të metrologjisë ligjore.

4. Nëse ankesa nuk parashtrohet sipas afatit të përcaktuar në paragrafi 8. të nenit 24 të këtij ligji, Drejtorati i metrologjisë ligjore, merr vendim për dëmtimin e këtyre punimeve.

5. Punimet të cilat dëmtohen në laboratorin e metaleve të çmuara, i kthehen palës.

Neni 26 Procedura e inspektimit

1. Inspektori i metrologjisë gjatë mbikëqyrjes metrologjike është i detyruar të kryej mbikëqyrjen metrologjike të punimeve nga metalet e çmuara.

2. Procedura e inspektimit metrologjik të punimeve nga metalet e çmuara përcaktohet me akt nënligjor.

Neni 27 Dispozitat Ndëshkuese

1. Me gjobë prej dymijë (2000) deri gjashtëmijë (6000) Euro dënohet subjekti afarist i cili merret me punimet e punuara nga platina, ari nëse:

1.1. punimet para se të vendosen në treg nuk i nënshtrohen ekzaminimit;

1.2. bëhet bartja e pjesës së shënuara nga një punim në tjetër punim.

2. Me gjobë prej njëmijë (1000) deri tremijë (3000) Euro dënohet personi përgjegjës i subjektit, nëse nuk është në pajtim me nënparagrafin 1.1. dhe 1.2. të këtij neni.

3. Me gjobë prej pesëqind (500) deri njëmijë e pesëqind (1500) Euro dënohet subjekti afarist i cili merret me shitjen e punimeve e punuara nga argjendi, paladiumi nëse:

3.1. punimet para se të vendosen në treg nuk i nënshtrohen ekzaminimit;

3.2. bëhet bartja e pjesës së shënuara nga një punim në tjetër punim.

4. Me gjobë prej treqind (300) deri nëntëqind (900) Euro dënohet personi përgjegjës i subjektit afarist, nëse nuk është në pajtim me nënparagrafin 3.1. dhe 3.2. të këtij neni.

Neni 28

1. Me gjobë prej njëqind (100) deri treqind (300) Euro dënohet subjekti afarist dhe personi fizik nëse:

1.1. nuk i vendos në vend të dukshëm fotot e shenjave të harmonizimit për vërtetimin e pastërtisë së punimeve nga metalet e çmuara;

1.2. nuk posedon thjerrëzën zmadhuese për kontrollim e vulave në punime;

1.3. nuk posedon peshoren e verifikuar nga Laboratori i Masës, dhe nuk e vendosë në vend të dukshëm dhe me mundësi leximi nga konsumatori.

2. Të gjitha gjambat e parapara sipas këtij ligji shqiptohen nga inspektorati i tregut.

Neni 29

Aktet nënligjore të aplikueshme deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore

1. Me kusht që të mos jenë në kundërshtim me këtë ligj dhe deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore për zbatimin e drejtë dhe të plotë të këtij ligji, aktet nënligjore të aplikueshme aktualisht do të vazhdojnë të mbeten në fuqi si në vijim:

1.1. Udhëzimi Administrativ Nr. 2008/04 Për përcaktimin e tarifave të përshtatshmërisë së punimeve nga metalet e çmuara;

1.2. Udhëzimi Administrativ Nr. 2008/06 Për shenjat e prodhuesi, punuesit dhe shitësve të punimeve nga metalet e çmuara;

1.3. Udhëzimi Administrativ Nr. 2008/07 Për formën dhe përmbajtjen e shenjave të pastërtisë, mënyrën e përcaktimit dhe shënimit të shkallës së pastërtisë të punimeve nga metalet e çmuara;

1.4. Udhëzimi Administrativ Nr. 2010/06 Për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit administrativ nr. 2008/07 Për formën dhe përmbajtjen e shenjave të pastërtisë, mënyrën e përcaktimit dhe shënimit të shkallës së pastërtisë të punimeve nga metalet e çmuara.

Neni 30

Dispozitat Kalimtare

Ministri i Ministrisë përkatëse të Tregtisë dhe Industrisë për zbatim të këtij ligji detyrohet të nxjerr akte nënligjore në pajtim me ligjin brenda dymbëdhjetë (12) muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 31

Dispozitat Shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji nr. 2004/28 Për punimet nga metalet e çmuara, si dhe aktet tjera që janë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 32
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-154
13 dhjetor 2012

Shpallur me dekretin Nr. DL-061-2012, datë 27.12.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga